



Npi – 01/41 datë: 28.02.2022

Duke u bazuar në nenin 43 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/114 të datës: 26.04.2019, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më: 28.02.2022 është nxjerrë ky:

**E K S T R A K T**  
**P R O C E S V E R B A L**

**I M B L E D H J E S Ë -II- TË R R E G U L L T TË K U V E N D I T TË K O M U N Ë S SË S H T I M E S**  
E mbajtur më: 28.02.2022, (e hënë) në ora 9.<sup>oo</sup> h. në sallën e Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi i Kuvendit: z.Adnan Ademi, Antarët e Kuvendit: z.Rrahman Jakupi, z.Përparim Ramusa, z.Lumni Amrushu, znj.Besartë Musliu-Spahija, z.Adem Ramadani, z.Hasan Avdyli, z.Hamëz Tërshani, znj.Albana Podvorica, znj.Adelina Beqaj, z.Besnik Seferi, z.Gëzim Haxhiu, z.Reshat Mujota, z.Asllan Beqaj, znj.Shkurte Mustafa, znj.Sanije Sadiku, znj.Heroina Selmani, z.Kadri Emini, znj.Rrezartë Ramadani, z.Muhamet Ademaj, z.Rexhep Gashi.

Në mbledhje përveç anëtarëve të Kuvendit kanë marrë pjesë edhe: Kryetari, z.Qemajl Aliu, Drejtorët, nga ZKF-ja z.Bujar Ferati dhe znj.Kimete Ukaj, nga Zyra Ligjore, z.Lulzim Muharremi, nga OJQ "YAHR" z.Ferdian Shala, Nga Zyra për Informim, z.Gazmend Ademaj.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit konstatoj, Kuorumin prej 21 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

**R E N D I T E**

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 28.01.2022
2. Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit Npi-01/11 për zgjedhjen e KPF-së, sipas kërkesës të MPL-së Nr.020-108-5 të dt.21.02.2022.
3. Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit Npi-01/12 për zgjedhjen e KPK-së, sipas kërkesës të MPL-së Nr.020-108-3 të dt.16.02.2022.
4. Propozim-Plani i Punës së Kuvendit për vitin 2022,
5. Pasqyrat Financiare për vitin 2021,
6. Raporti Periodik për zbatimin e rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm,
7. Zgjedhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi,
8. Pyetje Përgjigje,

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Hapi diskutimin për rendin e ditës.  
**z.Përparim Ramusa;** Përshëndetje, në emër të PDK-së unë propozoj që pika e 8 të del në vendin e dytë.

**z.Rexhep Gashi;** Përshëndetje, fillimisht materiali nuk na ka ardhur me kohë. E dyta nuk e kemi në rendin e ditës Propozim-Rregulloren për Taksa për vitin 2022 e cila ka qnë në diskutim publik. Propozoj që si pikë shtesë të futet edhe “Rishikimi i Drejtorive Komunale”.

**z.Kadri Emiri;** Sa i përket propozimit që pika e 8 me dalë në vend të pikës 2, unë kam një propozim krejt tjetër, që kjo pikë “Pyetje-Përgjigje”, mos me qenë fare në rendin e ditës, kjo edhe është arsyetuar atëherë nga ish Kryetari i atëhershëm. Dmth. sot le të jetë si pikë e rendit të ditës por që në mbledhjet e radhës mos të jetë si pikë e rendit të ditës, kjo për arsye se ne kemi të drejtë ligjore në çasje të drejtpërdrejt në dokumentet zyrtare.

**z.Rexhep Gashi;** Replikë me Kadriun, ne duhet të marrim përgjegjësi, e kemi zyrtarin ligjor e jo të bëheni avokat. Dhe duhet të respektohet rregullorja e punës.

**z.Reshat Mujota;** Përshëndetje, sa i përket rendit të ditës, unë pajtohem që pika e 8 të kalojë në vendin e pikës 2, për arsye se drejtorat pastaj nuk janë të detyruar që të qëndrojnë në mbledhje deri në pikën e fundit të rendit të ditës. Nuk pajtohem me kërkesën e Kadriut që pika “Pyetje-Përgjigje” të hiqet krejt nga rendi i ditës, nëse duam që gjithçka të jetë transparente.

**z.Besnik Seferi;** Përshëndetje, sa i përket pikës “Pyetje-Përgjigje”, jam i pajtimit, e sa i përket pikës shtesë Rishqyrtimi i drejtorive të propozuar nga Rexhep Gashi unë i them Rexhës, se ne më parë asnjëherë nuk kemi kërkuar rishqyrtim të drejtorive. Unë mendoj se shumë më me rëndësi është që ti themelohet Komitetet dhe organet tjera të Kuvendit. Unë propozoj që pika 2 dhe 3 e rendit të ditës të jetë si pikë e vetme dhe të votohet në pako.

**z.Rexhep Gashi;** Replikë me Besnik Seferin, në emër të subjektit kam të drejtë në replikë, të nderuar unë bajraktarizëm nuk do të bëjmë, për bajraktarizëm kanë qenë individë që thojshin na, na, nuk thuhet na na sepse kjo do të humbet shumë shpejtë. Unë kam qenë opozitë dhe opozitë do të mbes, unë kam të drejtë që të propozojë si subjekt politik, dhe do ta ngris zërin çdo herë.

**z.Përparim Ramusa;** Unë kam një pyetje, se pse nuk ka transmetim të drejtpërdrejtë?

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Unë posa e mora informacionin nga puntoret teknik se janë duke punuar në këtë drejtim, mirëpo, unë nuk e di konkretisht se ku qëndron problemi. Në vazhdim unë do ta qes në votim propozimin e Bujar Feratit (ZKF) që për pikat e rendit të ditës me numër 5 dhe 6 të dalin të parat 2 dhe 3 dmth. pas procesverbalit, për shkak se kanë punë, dhe të raportojnë më heret.

**z.Përparim Ramusa;** Propozoj që pika 8 e rendit të ditës “Pyetje – Përgjigje” të jetë e 2 ndërsa si pika 3 dhe 4 të dalin, pikat që i propozojë Bujar Ferati, zyrtarë kryesor financiar.

**z.Reshat Mujota;** Sipas rregullores qitet në votim rendi i ditës i propozuar nga Kryesuesi, nëse kalon mirë nëse jo atëherë qiten në votim me propozimet ashtu qysh u dhanë nga kolegët asambleistë.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Konstatoi, Kuorumin prej 21 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

**\* Kuvendi i Komunës, me 9 vota “Për” me 12 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim” nuk e aprovoi rendin e ditës të propozuar nga Kryesuesi i Kuvendit.**

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Tani po e qes në votim rendin e ditës me propozimet e dhëna, që pika 8 e rendit të ditës “Pyetje – Përgjigje” të jetë e 2 ndërsa si pika 3 dhe 4 të dalin, pikat që i propozojë Bujar Ferati, zyrtarë kryesor financiar.

**\* Kuvendi i Komunës, me 13 vota “Për” me 5 vota “Kundër” dhe me 3 vota “Abstenim” aprovoi, rendin e ditës me ndryshimet e propozuara si vijon:**

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 28.01.2022,
2. Pyetje Përgjigje,
3. Pasqyrat Financiare për vitin 2021,
4. Raporti Periodik për zbatimin e rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm,
5. Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit Npi-01/11 për zgjedhjen e KPF-së, sipas kërkesës të MPL-së Nr.020-108-5 të dt.21.02.2022,
6. Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit Npi-01/12 për zgjedhjen e KPK-së, sipas kërkesës të MPL-së Nr.020-108-3 të dt.16.02.2022,

7. Propozim-Plani i Punës së Kuvendit për vitin 2022,
8. Zgjedhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi,

**z.Rexhep Gashi;** Unë kërkoj që të qitet në votim propozimi im për rishqyrtimin e drejtorive.

**z.Përparim Ramusa;** Sipas rregullores duhet të qitet në votim propozimi i çdo antari të Kuvendit.

**Kryetari, z.Qemajl Aliu;** Përshëndetje për të gjithë, unë kisha dashtë me ju lutë si Kryetarë që të bëheni më konstruktiv dhe të bëheni të arsyeshëm dhe mos të dalim këtu si në teatër dhe mos ti torturojmë qytetarët me lloj-lloj dëshirash, unë e kuptoj atë idenë e arrogancës së votave, por me kthimin e dy vendimeve të Kuvendit për formimin e Komiteteve nga MPL-ja, por shihet qartë që nuk po merren vendime të duhura në përputhje me ligjin, unë kam vendosur që ndoshta të qeverisë edhe me pakicë në Kuvend por gjithmonë në interes të qytetarit dhe në përputhje me ligjin.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** E ftoi zyrtarin ligjor z.Lulzim Muharremi që të jepë sqarimet e nevojshme, lidhur me propozimin shtesë të Rexhep Gashit.

**z.Lulzim Muharremi, zyrtarë ligjor;** Lexoi nenin 9 pika 2 të rregullorës të MAPL-së.

**z.Përparim Ramusa;** Po lidhem te fjalimi i Kryetarit, po bëhen 3 muaj që ende nuk e ke Nënkryetarin, e as drejtorin për shërbime publike. Pastaj ke pru drejtorë nga komunat tjera. Ne dallojmë nga aspekti politik, por në aspektin njerzorë jemi të njëjtë.

**Kryetari, z.Qemajl Aliu;** Pajtohem që dallojmë politikisht, pikërisht për shkak të parimeve, prandaj po them se këtu po mungojnë vetëm çështjet parimore të punës. Ju e keni masakruar pronën komunale, nuk ka mbetur më pronë komunale për ndonjë projekt, kështu që ju bashkë me ish Kryetarin, ju keni dhënë shokëve e përkrahësve të juaj pronë komunale në shfrytëzim. Përtej dëshirave që mund ti keni ju dhe kolegët tuaj ne kemi rregullore dhe ligje të cilat duhet patjetër të respektohen.

**z.Përparim Ramusa;** Pikërisht subjekti që e përfaqëson ti e ka bërë shkeljen e rregullorës, sepse e ka propozuar në Komitetin njërin nga antarët e subjektit tjetër. Qysh mundet me kanë parim kur e ke emëruar drejtoresh, vajzën e këshilltarit z.Muhamet Ademaj për me ja ble votën.

**Kryetari, z.Qemajl Aliu;** Unë kamë koalicion me LDK-AKR, kështu që unë nuk mund të ju përzihem atyre se kënd e dërgojnë kandidat për drejtor, kjo është krejtësisht çështje e tyre.

**znj.Adelina Beqaj;** Ne po diskutojmë për rendin e ditës nëse nuk votohet rendi i ditës, kërkoj një shpjegim nga zyrtari ligjor se qysh procedohet më tutje për votimin e rendit të ditës.

**z.Kadri Emini;** Unë dua të sqaroj se LDK dhe AKR janë bashkuar në një grup parlamentarë, dhe jemi në koalicion me LVV. Ne e kemi kërkuar një emër nga AKR-ja për drejtor dhe Kryesia e AKR-së e ka dërguar emrin e vajzës së Muahmet Ademaj, dhe Kryetari e ka emëruar. Ky është sqarimi.

**z.Reshat Mujota;** Janë dalë në shesh çështjet personale, tash unë nuk e di a është bërë koalicion në mes të LVV dhe LDK-AKR apo është bërë koalicion në mes Kryetarit dhe LDK-AKR.

**z.Kadri Emini;** Koalicioni është bërë në mes LVV dhe LDK-AKR.

**z.Lulzim Muharremi, zyrtarë ligjor;** Unë e dhash sqarimin edhe pak më parë, dhe e lexova nenin 9.2 të rregullorës së MPL-së ku thotë se: "Në rendë dite mundë të futet edhe një pikë e cila është urgjente dhe me rëndësi publike".

**znj.Adelina Beqaj;** Kjo pikë nuk është urgjente, por është me rëndësi publike. Sa i përket transmetimit të mbledhjes, ne duam të jemi transparent dhe kërkoj nga ti si Kryesues, që ta rregullosh këtë çështje ose ne do ta lëshojmë mbledhjen.

**Kryetari, z.Qemajl Aliu;** Sa i përket drejtorive, nëse e lexoni nenin 54 pika 4 të Statutit të Komunës së Shtimës do ta shihni se Kryetari i propozon Kuvendit për çdo vitë fiskal, numrin e drejtorive dhe funksionet e tyre në pajtim me ligjin në fuqi.

**z.Lumi Amrushi;** Përshëndetje, e përgëzoj Adelinen për këmbëngulësin e saj.

**z.Rrahman Jakupi;** Është mirë me e hedh në votim, pse po zgjatet. A janë të ligjshme apo jo e konfirmon MPL-ja ndërsa është çështje e Kuvendit se a kalon apo nuk kalon.

**z.Reshat Mujota;** Qite në votim nëse i merr votat kalon, sepse ne nuk e dimë nëse i merr ose jo votat.

**z.Rexhep Gashi;** Unë jam i vetëdijshëm për propozimet e Kryesuesit dhe të Kryetarit, mirëpo unë mendoj se duhet të qitet në votim edhe propozimi im.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Dha 10 minuta pauzë, rreth orës 10.30h

Pas pauzës:

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Pas pauzës, Kryesuesi vazhdoi me mbledhjen në ora 10.54h.

**z.Kadri Emini;** Unë propozoj që të shtyhet vazhdimi i kësaj mbledhje, sepse siç po shihet anëtarët e Kuvendit nga subjekti politik i PDK-ë nuk po marrin pjesë në këtë mbledhje, asnjë nga ata nuk janë prezent në mbledhje, edhe pse nuk ka ndonjë paralajmërim se do ta lëshojnë mbledhjen e Kuvendit. Unë propozoj që para se të thirret vazhdimi i kësaj mbledhje të mbahet një takim pune me përfaqësuesit e subjekteve politike.

**z.Besnik Seferi;** Edhe unë i bashkangjitem propozimit të Kadriut që të shtyhet vazhdimi i kësaj mbledhje për një ditë tjetër.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Unë do ta qes në votim propozimin e Kadriut që të shtyhet vazhdimi i kësaj mbledhje për një ditë tjetër. Në vazhdim Kryesuesi, konstatoi, Kuorumin prej 12 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

**\* Kuvendi i Komunës, unanimisht e miratoi propozimin e Kadri Eminit dhe Besnik Seferit që vazhdimi i kësaj mbledhje të shtyhet për një ditë tjetër, me rekomandimin që para mbledhjes të mbahet një takim pune me përfaqësuesit e subjekteve politike, për ti harmonizuar qëndrimet.**


**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Meqenëse Kuvendi e miratoi propozimin e anëtarit Kadri Emini që mbledhja të shtyhet, mbledhjen për sot po e përfundoj në ora 11.02h.

Procesmbajtësi:  
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Kuvendit

Adnan Ademi



## VAZHDIMI I MBLEDHJES SË -II- TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHITES

E mbajtur më: 22.03.2022, (e martë) në ora 9.<sup>00</sup> h. në sallën e Kuvendit.

Në Vazhdimin e mbledhjes së Kuvendit kanë marrë pjesë, Kryesuesi i Kuvendit: z.Adnan Ademi, Antarët e Kuvendit: z.Rahman Jakupi, z.Përparim Ramusa, z.Lumni Amrushi, znj.Besartë Musliu-Spahija, z.Adem Ramadani, z.Hasan Avdyli, z.Hamëz Tërshani, znj.Albana Podvorica, znj.Adelina Beqaj, z.Besnik Seferi, z.Gëzim Haxhiu, z.Reshat Mujota, z.Asllan Beqaj, znj.Shkurte Mustafa, znj.Saniye Sadiku, znj.Heroina Selmani, z.Kadri Emini, znj.Rrezartë Ramadani, z.Muhamet Ademaj, z.Rexhep Gashi.

Përveç anëtarëve të Kuvendit kanë marrë pjesë edhe: Kryetari, z.Qemajl Aliu, Drejtorët, nga ZKF-ja z.Bujar Ferati dhe znj.Kimete Ukaj, nga Zyra Ligjore, z.Lulzim Muharremi, nga njësitë për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore z.Reshat Gashi, nga OJQ "Vizionida" znj.Zhaneta demiri, nga OJQ "YHR" z.Ferdian Shala, nga RZSH z.Muhamet Hoxha, nga Zyra për Informim, z.Gazmend Ademaj dhe Shpëtim Gashi, si dhe TV – "Spin" Shtime.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit konstatoi, Kuorumin prej 21 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje. Në vazhdim Kryesuesi tha se mbledhja e datës 28.02.2022 u ndërpre sepse subjekti politik PDK-ja e nuk u kthyen më në mbledhje të Kuvendit nga pauza, pa na dhënë ndonjë sqarim. Ne që mbetëm në mbledhje e kishim kuorumin për të vazhduar mbledhjen por, deputeti, Kadri Emini, propozoj që të shtyhet vazhdimi i mbledhjes, sepse anëtarët e Kuvendit nga subjekti politik i PDK-ë nuk janë prezent në këtë mbledhje.

edhe pse nuk ka ndonjë paralajmërim se do ta lëshojnë mbledhjen e Kuvendit. Siq dihet pra rendin e ditës e kemi miratuar në pjesën e parë të kësaj mbledhje më 28.02.2022 të cilin po e lexoj dhe pastaj do të vazhdojmë me shqyrtimin e pikave një nga një si vijon:

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 28.01.2022,
2. Pyetje Përgjigje,
3. Pasqyrat Financiare për vitin 2021,
4. Raporti Periodik për zbatimin e rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm,
5. Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit Npi-01/11 për zgjedhjen e KPF-së, sipas kërkesës të MPL-së Nr.020-108-5 të dt.21.02.2022,
6. Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit Npi-01/12 për zgjedhjen e KPK-së, sipas kërkesës të MPL-së Nr.020-108-3 të dt.16.02.2022,
7. Propozim-Plani i Punës së Kuvendit për vitin 2022,
8. Zgjedhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi,

**z.Përparim Ramusa;** Përshendetje, në mbledhjen e kaluar rendi i ditës nuk ka kaluar, dmth nuk është e saktë se rendi i ditës është aprovuar, prandaj unë po kërkojë që ta qitni në votim miratimin e rendit të ditës.

**z.Reshat Mujota;** Përshendetje, rendi i ditës nuk është votuar siç po thuani, pse pra atëherë PDK-ja e ka lëshuar mbledhjen e Kuvendit, pikërisht për arsye se nuk janë qit në votim rendi i ditës, po ashtu nuk janë qitë në votim propozimet tona. Ne që kemi mbetur në pjesën e dytë të mbledhjes e kemi shty mbledhjen.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Sekretaria e Kuvendit e ka punuar pjesën e provesverbalit nga mbledhja e cila është ndërpre, dhe në vazhdim e lexoi pjesën e procesverbalit në të cilën është aprovuar rendi i ditës si vijon: **“Kuvendi i Komunës, me 9 vota “Për” me 12 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim” nuk e aprovoi rendin e ditës të propozuar nga Kryesuesi i Kuvendit.**

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Tani po e qes në votim rendin e ditës me propozimet e dhëna, që pika 8 e rendi të ditës “Pyetje – Përgjigje” të jetë e 2 ndërsa si pika 3 dhe 4 të dalin, pikat që i propozojë Bujar Ferati, zyrtarë kryesor financiar.

**\* Kuvendi i Komunës, me 13 vota “Për” me 5 vota “Kundër” dhe me 3 vota “Abstenim” aprovoi, rendin e ditës me ndryshimet e propozuara”.**

Po ashtu është edhe stenogrami i mbledhjes të cilin mundë ta keni në dispozicion e i cili dëshmon se rendi i ditës është aprovuar. Unë mendojë se mbledhja është ndërprerë edhe për shkak të faktit se deputetja znj.Adelina Beqaj tha se mbledhjen do ta lëshojmë për shkak se nuk është siguruar transmetimi i seancës.

**z.Besnik Seferi;** Përshendetje, unë mendojë se procesverbali i mbledhjes së kaluar është dashur me ardhë pa marrë parasysh.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Procesverbali nuk mund të vjen në Kuvend sepse mbledhja është ndërprerë. Kur të përfundon mbledhja komplet edhe procesverbali vjen komplet për miratim. Mirpo sekretaria e ka punuar pjesën e parë dhe e kemi këtu. Ne do të vazhdojmë me shqyrtimin e pikës së parë.

**znj.Adelina Beqaj;** Përshendetje, sa i përket rendit të ditës nuk është aprovuar. Nëse është vullneti i shumicës, pse mos me qit në votim.

**z.Përparim Ramusa;** Në mbledhjen e kaluar që u ndërpre Rexhep Gashi e ka pas një propozim për rishikimin e drejtorive, e cila nuk është qit në votim, prandaj kjo pra ka qenë arsyeja që e kemi lëshuar mbledhjen.

**z.Rexhep Gashi;** Në mbledhjen e kaluar unë kam kërkuar një pikë shtesë për sa i përket rishikimin e drejtorive. Meqënëse pikat e rendit të ditës kan kaluar ashtu qysh kan kaluar, ne të gjithë asambleistët jemi këtu për interesin e qytetarit, prandaj këtë pikë nuk e kemi kërkuar rastësishtë. Për kundër kësaj unë propozojë që kjo pikë për rishqyrtimin e drejtorive të futet në mbledhjen e radhës të Kuvendit e sot të vazhdojm me këto pika.

**z.Reshat Mujota;** Më vjen turp prej kolegeve që e shkelin betimin e tyre. Nuk është e vërtet që ka kaluar rendi i ditës. Unë kam ndejtë në mbledhje edhe pas pauzës por me pas ditë nuk kisha nejtë. Kemi edhe një vendim për drejtori që është kthyer nga MAPL-ja, të cilin mundet me kthy sekretaria .

**z.Idajet Rexhepi, Zyrtar i Kuvendit;** Në sekretarin e Kuvendit nuk kemi asnjë vendim tjetër nga MAPL-ja nga këto dy vendime për formimin e Komiteteve që janë paraqitura me rendin e ditës.

**z.Rrahman Jakupi;** Përshëndetje, rendi i ditës nuk është aprovuar. Unë kërkojë që të hedhen në votim propozimet që ipen në Kuvend. Lexojeni mirë nenin 6.3 të rregullorës së punës të Kuvendit. Unë konsideroj se e njohë mirë ligjin për vetëqeverisje lokale si dhe rregulloren e punës së Kuvendit të cilën sot jeni duke e shkelur me të dyja këmbët. Nëse doni me vazhdu atëherë së pari hidhe në votim rendin e ditës si dhe propozimet sepse është vullneti i shumicës. Nëse nuk hudhet në votim rendi i ditës ashtu qysh e propozojmë dhe e parashih neni 6.3 i rregullorës të punës së Kuvendit, ne nuk kemi qka të qëndrojmë në mbledhje.

**z.Besnik Seferi;** Unë kamë qenë hartues i kësaj rregullore, dhe jam për ta zbatuar. Sa i përket PDK-së aq shumë herë e marrin fjalën dhe i perserisin gjërat që rregullorja e punës shkelet shumë herë. Është mirë që sot po ju bjen ndërmendë për vendimin e formimit të dy drejtorive në të kaluarën, e sot po kërkon që ato me u anuluar. Nuk duhet të bëni lapsuze të tilla. Ne sot duhet të jemi të akorduar që vendimet të aprovojmë dhe të vazhdojmë punën e Kuvendit. Unë po propozoj që ta marrim një pauzë dhe të dakordojmë qëndrimet për ta vazhduar mbledhjen.

**z.Rrahman Jakupi;** Replikë me Besnik Seferi, unë e kuptoj paraqitjen e juaj për të qenë në qendër të vëmendjes, po neve po na intereson që rendin e ditës ta hedhni në votim.

**z.Përparim Ramusa;** Nuk është mirë me mbajtë këtu ders politik. Ti Besnik e ke propozuar Rexhep Gashin për antarë të KPF-së. Rregullorja e Kuvendit e thotë që ç’do propozim me e qitë në votim, këtë po e kërkojmë ne.

**z.Besnik Seferi;** Replikë me Përparim Ramusa unë e kam paraqitë propozimin për Rexhep Gashi në emër të LVV-së por nuk kam qenë votues. Me këtë une thashë se duhet të rrespektohet rregullorja.

**z.Kadri Emiri;** Po flitet për respektimin e rregullorës , ne të gjithë e kemi shkelë rregullorën më shumë se 15 herë, kështu që më mirë mos u thirrni në respektimin e rregullorës. Për funksionalizimin e Komiteteve është përgjegjësi e Kuvendit e jo e Kryetarit, qoftë ajo pozitë ose opozitë. Jemi në pikën ku është konsomuar diskutimi për rendin e ditës, po meqenëse kta po kërkojnë me ngulm, atëhere qite në votim edhe njëherë rendin e ditës.

**z.Rexhep Gashi;** Unë nuk kam bërë kurfarë pazari me askënd. Në fillim thashë se jemi të obliguar që të punojmë për interes të qytetarit. Sa i përket propozimit tim në mbledhjen e kaluar për rishqyrtimin e drejtorive unë e thashë dhe po e perseris se propozimin ta shqyrtojmë në mbledhjen e radhës dhe kërkojë që të futet në rendin e ditës.

#### Pika 1

##### Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 28.01.2022.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Hapi diskutimin për këtë pikë.

**z.Asllan Beqaj;** Përshëndetje, nëse e kemi votuar rendin e ditës, më 28.01.2022 nuk kemi më qka të diskutojmë.

Rreth orës 10:12h. subjekti politik PDK-ja e lëshoj mbledhjen e Kuvendit.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;**Konstatoi, Kuorumin prej 11 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

**\*Kuvendi i Komunës, unanimitisht miratoi, Ekstrakt Procesverbalin nga mbledhja më 28.01.2022,**

#### Pika 2

##### Pyetje Përgjigje

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Hapi diskutimin për këtë pikë.

**z.Muhamet Ademaj;** Kam këto pyetje: Për DPUKGJ-në, në rrugën “Skender Salihaj” në Shtime, punimet kanë filluar në muajin Shtator 2021, pse janë ndërprerë punimet në këtë rrugë?

Te Drejtoria e Prokurimit Publik po e kërkoj listën e projekteve kapitale për operatorët ekonomik që i kanë kryer punimet gjatë vitit 2020-2021?

**z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ;** Në këtë rrugë ne kemi pasë një problem me operatorin ekonomik por besojë se brenda dy muajve puna do të vazhdojë aty.

**z.Besnik Seferi;** Më vjen keq nga PDK-ja që është këtu me tendencë që ne të dalim sa më keq. Në vazhdim unë kam këto pyetje: Unë i kamë nje pyetje që ka të bëjë me shtatoren e Adem Jasharit e cila është zbuluar më 28.11.2021, unë mendoj se nuk ka përfunduar krejtësisht sepse aty po mungon ndriqimi që duhet ti bëhet shtatores, prandaj unë kërkoj që të rregullohet ambienti aty? Kontejnerët gjithandej janë të stërbushur me mbeturina, kërkoj nga drejtoria për shërbime publike që të ndërmarrë masa për sanimin e gjendjes? Te drejtoria për Shëndetësi, Rentgeni në QKMF-ë nuk është duke punuar, a është duke u marrë dikush me këtë çështje për rregullimin e rentgenit? Për DPUKGJ-në, a është e planifikuar zgjerimi i rrugës për te shkolla e Mesme, sepse siç e dime ajo rrugë është shumë e ngushtë? Te kalimet për këmbësorë (zebrat) nuk kanë sinjalizim përkatës, unë kërkoj nga drejtoria për shërbime publike që ato të përcillen me shenjat adekuate të komunikacionit?

**z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ;** Sa i përket Shtatores të Komandantit Legjendar Adem Jashari ne nuk kemi asnjë planifikim, dhe nuk jemi konsultuar fare, mirëpo ne po planifikojmë trajtimin e sajë më të gjerë. Sa i përket pengesave ato janë të përkohshme.

**z.Isa Haxhiu, drejtor i DSHMS;** Përsëritet, është e vërtetë se rentgeni është defekt, dyshohet se te defekti ka ardhur për shkak të luhatjes së rrymës, nuk e di a ka pas sistem mbrojtës apo jo. Nuk ka pas tender për mirëmbajtje, tani sa e di janë në pyetje 3.500€ për rregullimin e tij, dhe kthe na e ka thënë Servisi, mirëpo edhe servisi është duke pritur një përgjigje nga Japonia.

**z.Rexhep Gashi;** Kam këto pyetje: Pyetje për Drejtorinë e Inovacionit çka mendon kjo drejtori, kur kabinetin e ka në shkollën profesionale ndërsa zyret në Komunë, ku e ka paralizuar punën në katin e parë me këto kabinete dhe është rritur kostoja e shpenzimeve, ku shkolla profesionale është obliguar që të punoj në dy ndrrime? Dhe sa është numri i stafit në Drejtorinë e Inovacionit? Pyetje për DPUKGJ-në projektet që janë duke vazhduar të cilat janë për të mirën e qytetarit, ku në disa rrugë mungojnë pasqyret e këndeve të vdekura, kur do të rregullohen këto pasqyre? Pyetje për Administratën, sa automjete të Komunës janë funksionale, dhe pse në ditët përkujtimore nuk kanë qenë funksionale të gjitha automjetet dhe nuk kanë qenë prezent shoferat, ku ka pas edhe ndërhyrje të qytetarëve në automjetet e komunës? Pyetje për DKA-në, a është e lejuar të japin mësim praktikantët pa prezencën e arsimtarit?

**z.Kadri Emini;** Nëse drejtorat kanë mundësi me u përgjigjë tani mirë nëse jo qteherë le të përgjigjen me E-mail, për ta kursyer kohën.

**z.Rexhep Gashi;** Për mua është shumë e rëndësishme që ti kemi përgjigjet, por le të mbetet në përgjegjësin e tyre se a dojnë me u përgjigj tash apo me email.

**z.Valon Januzi, drejtor për Administratë;** Përsëritet, Komuna e jon ka 5 vetura si dhe dy vetura i kemi me qera. Sa i përket shënitit të përvjetoreve, ne kemi një bashkëpunim të mirë me shoqatat e dalura nga lufta, po ashtu kemi pas edhe shumë zyrtarë që kanë ardhur me veturat e tyre. Prandaj konsideroj se qështja e transportit në rastet e përvjetoreve nuk është ndojnë problem i madh.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** E ndërprej mbledhjen e Kuvendit në ora 10:18h për shkakë të mungesës së kuorumit. Pas 2 minutave mbledhja e Kuvendit vazhdon meqenëse u kthye në mbledhje njëri nga antarët e Kuvendit.

**Kryetari, z.Qemajl Aliu;** Përsëritet, siç po duket dikush ka harruar se për çka ka ardhur këtu në Kuvend. Kjo opozitë siq e patë edhe ju nuk po mundë të pajtohet me rolin e saj si opozitë. Do të jetë hera e fundit kjo që opozita për shkakë të numrave do të mundë ta bllokoi ose saboton punën e Kuvendit. Formimi i komiteteve është punë e Kuvendit dhe është dashur të formohen ashtu që vendimet të mos na kthehen nga MAPL-ja për rishqyrtim. Këta e lëshuan mbledhjen pa e dhënë asnjë arsytim, duke luajtur zhurmuesin në Kuvend. Ne kemi mbi 60 projekte që po presin ti qojmë përpara, ne nuk lejojmë që ketu të bëhet bllokim i punës, prandaj u bëjë thirrje të gjithë antarëve të

Kuvendit mos të ndjekin agjenda të ish pushtetit, por të vijnë në Kuvend dhe të punojmë bashkarishtë për interesin e qytetarëve së Komunës sonë.

### Pika 3

#### Pasqyrat Financiare për vitin 2021

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Për prezantimin e kësaj pike Kryesuesi fjalën ja dha Bujar Feratit.

**z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar;** Përshëndetje, materialin për këtë pikë e keni marrë me kohë në formë të shkruar dhe e keni lexuar. Në vazhdim z.Bujar Ferati, prezantoi pasqyrat financiare sipas tabelave duke lexuar shifrat sipas Kategorive Ekonomike. Unë i mirëpres pyetjet ose sygjerimet e juaja, (shih dokumentin).

**z.Asllan Beqaj;** Përshëndetje, lidhur me pasqyrat financiare kemi edhe të gjeturat nga auditori i përgjithshëm, për procedurat e përmbarimit, unë dua ta di se sa ka borgje Komuna jonë?

**z.Kadri Emini;** Sa i përket pasqyrave financiare, këtu janë prazantuar ashtu siq kanë ndodhur shpenzimet, por mua po më intereson me ditë, sa mjete financiare janë shpenzuar për mëditjet zyrtare? Dhe qështja e dytë sa janë shpenzimet e pa arsyeshme për procedurat përmbarimore, dhe sa i përket kësaj unë mendoj se është keqmenaxhim. Prandaj unë tu kisha lutë që në mbledhjen e radhës me na i dhënë shënimet se sa mjete financiare janë shpenzuar pa arsye për këtë qëllim dmth. Te përmbaruesit.

**z.Besnik Seferi;** Unë në parim nuk jam për me e votuar këtë raport sepse po shihet në raport janë bërë korigjime e norme të pa nevojshme. Kështu pra edhe mënyra e ndarjes të subvencioneve nuk është bërë si duhet, për këtë arsye dhe për disa arsye të tjera ne nuk jemi që ky raport të kalojë.

**znj.Sanije Sadiki;** Përshëndetje, po bëhet fjalë për 55 mijë euro e cila është një shumë mjaftë e madhe dhe nuk po dihet se për cka janë shpenzuar unë po kërkojë një sqarim nga zyrtari për financa.

**z.Rexhep Gashi;** E përshendeti Bujarin për raportin por kam pyetje se sa projekte janë realizuar me kornizë kontrata, dhe sa kemi obligime financiare ndaj atyre operatoreve ekonomik?

**z.Asllan Beqaj;** Kërkoj nga zyrtari i financave që të na përgjigjet në pyetjen time, për arsye të qytetarëve.

**z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar;** Te 88 mijëshi, është obligim i bartur nga viti 2020 në vitin 2021, e që janë paguar. Shpenzimet prej rreth 23 mijë euro janë shpenzime për përmbaruesin për dy projekte në muajin Maj. Sa i përket kategorive, obligimet janë të pasqyruara te faja 27 e dokumentit. Përveq këtyre kemi edhe obligimet kontigjente që janë mjaft shumë dhe që është një problem në gjithë Kosovën. Ne kemi paguar rreth 111 mijë euro nga kategorija buxhetore paga dhe mëditje, por kemi obligime tjera rreth 600 mijë euro. Të tjerat mundemi me i elaboruar në pikën tjetër të rendit të ditës:

**z.Asllan Beqaj;** Unë prap nuk e mora përgjigjen e saktë se sa kemi borgje?

**z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar;** Te tabela Nr. 30 janë të sqaruara mirë të gjitha. Ne tani jemi në bashkëpunim me Thesarin që e ka marrë obligim pagesën, mirëpo po punojmë në drejtim që këto pagesa eventualisht, mos me u kryer dy herë. 108 mijë euro i kemi obligim që pritet me u ekzekutuar.

**znj.Kimete Ukaj, zyrtare financiare;** Përshëndetje, këtu në këtë raport nuk janë shumë të detajuara, Duhet ta bëni dallimin në mes obligimeve që kanë mbetur nga viti 2020 dhe detyrimeve kontigjente. Detyrimet kontigjente janë ato detyrime që faktikisht janë ende në procedurë Gjyqësore dhe nuk dihet saktësisht përfundimi i tyre. Sa i përket obligimeve që dalin nga Kontrata Kollektive kjo çështje nuk është problem vetëm i komunës tonë por në gjithë Kosovën.

**z.Lulzim Muharremi, zyrtar ligjor;** Përshëndetje, sa i përket obligimeve që dalin nga Kontrata Kolektive, po bëhet fjalë për sigurimin e shujtave dhe pagave jubilarë për periudhën nga viti 2015 deri në vitin 2018 që ka nënshkruar Qeveria, por që barrën ua ka lënë Komunave, kjo barrë është mjaft e rëndë dhe sfiduse për buxhetin Komunal. Tani ne jemi duke pranuar lëndë të shumta nga të punësuarit në të gjitha institucionet.



znj.Sanije Sadiki; Kam një pyetje, se kurë bëhet bartja e të hyrave vetanake nga viti 2021 në vitin 2022.

z.Asllan Beqaj; (Nuk e kam nuanë sepse ka lexuar në një dokument).

Kryesuesi, z.Adnan Ademi;Konstatoi, Kuorumin prej 11 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

\*Kuvendi i Komunës, me 0 vota “Për” me 9 vota “Kundër” dhe me 2 vota “Abstenim” nuk e miratoi këtë pikë.

z.Rexhep Gashi; Unë po propozoj një pauzë të shkurtë.

#### Pika 4

##### Raporti Periodik për zbatimin e rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Për prezantimin e kësaj pike Kryesuesi fjalën ja dha Bujar Feratit.

z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar; Është obligim Ligjor që Raportin Periodik për zbatimin e rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm ta prezantojmë në Kuvend. Disa rekomandime të Auditorit janë zbatuar e disa janë në proces. Materialin për këtë pikë e keni marrë me kohë në formë të shkruar dhe e keni lexuar. Nëse ka ndonjë pyetje unë jam këtu për tu përgjigjur.

z.Besnik Seferi; Pyetje për Zyrtarin Financiar, a keni vepruar mbi këtë plan? Unë besoj se gabime të tilla në mandatin tonë nuk do të ndodhin.

z.Asllan Beqaj; Kur tha Kimetja se janë bërë gabime disa me dashje e disa pa dashje, unë deshta me ditë qito gabimet me dashje cilat janë?

znj.Kimete Ukaj, zyrtare financiare; Nuk thash me dashje, por thash ndodhin pa dëshirën tonë, dmth. ato që ndodhin pa dijenin tonë, ose pa pasur qasje. Këtë raportim ne e bëjmë për me i treguar Kuvendit se sa kemi mundur me e realizuar planin që e kemi bërë për ti zbatuar rekomandimet e auditorit të përgjithshëm.


Kryetari, z.Qemajl Aliu; Ne do të bëjmë përpjekje që të gjeturat e auditorit të jenë minimale. Faturën e keqëqeverisjes e kanë marrë këta që kanë keqëqeverisur, e jo zyrtarët e administratës komunale.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Dha 10 minuta pauzë në ora 11.10h.

Pas pauzës:

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Vazhdoi mbledhjen e Kuvendit në ora 11.30h. Në vazhdim Kryesuesi e njopftoi Kuvendin se për arsye të mungesës të znj.Heroina Selmanit, nuk e kemi Kuorumin e mjaftueshëm për ta vazhduar mbledhjen, prandaj meqenëse në mbledhje janë prezent vetëm 10 anëtarë të Kuvendit, më duhet që ta ndërprej mbledhjen në ora 11.34h. me qëllim që ta vazhdojmë një ditë tjetër ku edhe do të njoftoheni me kohë.

Procesmbajtësi:  
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Kuvendit  
Adnan Ademi



#### VAZHDIMI I DYTË I MBLEDHJES SË -II- TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHITES

E mbajtur më: 28.03.2022, (e hënë) në ora 9.ºº h. në sallën e Kuvendit.

Në Vazhdimin e dytë të mbledhjes së -II- të Kuvendit kanë marrë pjesë, Kryesuesi i Kuvendit: z.Adnan Ademi, Antarët e Kuvendit: z.Rrahman Jakupi, z.Përparim Ramusa, z.Lumni Amrushi, znj.Besartë Musliu-Spahija, z.Adem Ramadani, z.Hasan Avdyli, z.Hamëz Tërshani, znj.Albana Podvorica, znj.Adelina Beqaj, z.Besnik Seferi, z.Gëzim Haxhiu, z.Reshat Mujota, z.Asllan

Beqaj, znj.Shkurte Mustafa, znj.Saniye Sadiku, znj.Heroina Selmani, z.Kadri Emini, znj.Rrezartë Ramadani, z.Muhamet Ademaj, z.Rexhep Gashi.

Përveç anëtarëve të Kuvendit në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: Kryetari, z.Qemajl Aliu, Drejtorët, nga ZKF-ja z.Bujar Ferati, nga Zyra Ligjore, z.Lulzim Muharremi, nga njësitë për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore z.Reshat Gashi, nga OSBE z.Mefail Mustafa, nga OJQ "Vizionida" znj.Zhaneta Demiri, nga OJQ "YAHR" z.Ferdian Shala, nga RZSH z.Muhamet Hoxha, Praktikantja znj.Valmira Hoxha, nga Zyra për Informim, z.Gazmend Ademaj dhe Shpëtim Gashi.

**Kryesuesi i Kuvendit z.Adnan Ademi;** Hapi mbledhjen dhe pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit Konstattoj, Kuorumin prej 21 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje. Në vazhdim Kryesuesi e njoftoi Kuvendin se në vazhdimin e parë të mbledhjes së -II- të Kuvendit e cila është mbajtur më datën 22.03.2022, janë përfunduar katër pikat e rendit të ditës si vijon:

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 28.01.2022,
  2. Pyetje Përgjigje,
  3. Pasqyrat Financiare për vitin 2021,
  4. Raporti Periodik për zbatimin e rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm,
- Tani na kanë mbetur për shqyrtim edhe pikat si vijon:
5. Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit Npi-01/11 për zgjedhjen e KPF-së, sipas kërkesës të MPL-së Nr.020-108-5 të dt.21.02.2022,
  6. Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit Npi-01/12 për zgjedhjen e KPK-së, sipas kërkesës të MPL-së Nr.020-108-3 të dt.16.02.2022,
  7. Propozim-Plani i Punës së Kuvendit për vitin 2022,
  8. Zgjedhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi,

Në vazhdim Kryesuesi, hapi diskutimin për rendin e ditës, nëse ka dikush me diskutu për këto që u thanë deri më tash.

**z.Përparim Ramusa;** Përshëndetje, ne si PDK-ë, e kemi dërguar një ankesë në MAPL-ë me arsyetimin për me vendosur ligjshmërinë në mbledhjet e kaluara nëse ka pas shkelje ligjore ose jo. Ne jemi për me vazhduar mbledhjen e Kuvendit.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Atëherë pra po vazhdojmë me pikën e 4 nëse ka Zyrtari Kryesor Financiar për me shtuar diçka lidhur me këtë pikë, meqenëse nuk kërkohet miratim prej Kuvendit.

#### Pika 4

##### Raporti Periodik për zbatimin e rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Për prezantimin e kësaj pike Kryesuesi fjalën ja dha Bujar Feratit.

**z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar;** Përshëndetje, ne e kemi elaboruar këtë pikë në mbledhjen e kaluar të Kuvendit. Disa rekomandime të Auditorit janë zbatuar e disa janë në proces. Materialin për këtë pikë e keni marrë me kohë në formë të shkruar dhe e keni lexuar. Nëse ka ndonjë pyetje unë jam këtu për tu përgjigjur.

**z.Besnik Seferi;** Përshëndetje, sa i përket raportit kemi diskutuar në seancën e kaluar. Unë po kërkoj që ZKF-ja të ketë një plan veprimi, kështu që në bazë të planit do të bëhet edhe zbatimi i rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm.

**z.Përparim Ramusa;** Edhe ne po kërkojmë një plan të veprimit, dhe do ti përmbahemi rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm.

#### Pika 5

##### Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit Npi-01/11 për zgjedhjen e KPF-së, sipas kërkesës të MPL-së Nr.020-108-5 të dt.21.02.2022

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Hapi diskutimin për këtë pikë, duke kërkuar propozime konkrete. Ju e keni marrë materialin për këtë pikë dhe e keni lexuar. MAPL-ja po kërkon që këtë vendim ta ndryshojmë për shkak të përfaqësimit jo adekuat në këtë Komitet.

**z.Përparim Ramusa;** Unë po kërkoj që ti shqyrtojmë të gjitha Komitetet një nga një. Ne si PDK i kemi propozimet e njejta te Komiteti për Politikë dhe Financa, ata që i kemi dhënë në mbledhjen e kaluar dhe po i përsëriti prap si vijon: Përparim Ramusa, Lumin Amrushi dhe Adelina Beqaj.

**z.Besnik Seferi;** Nga LVV Unë propozoj që dy Komitetet jo obligative të shkojnë në pako. Për Komitetin për Politikë dhe Financa ne i propozojmë këta emra si vijon: Kryesuesi i Kuvendit shkon me automatizëm, pastaj propozojmë Sanije Sadiku dhe Heroina Selmani.

**z.Muhamet Ademaj;** Nga koalicioni LDK-AKR unë e propozoj si anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa Kadri Eminin.

**z.Reshat Mujota;** Përshëndetje, po më vjen mirë që sot po vimë në mirëkuptim. Tash LVV-ja po e propozon Heroina Selmanin, ndërsa në mbledhjen e kaluar e kaluar e ka propozuar Rexhep Gashin. (Në vazhdim Reshat Mujota lexoi pjesë nga një dokument).

**Kryetari, z.Qemaj Aliu;** Përshëndetje, nuk kisha dashur që askush me e keqpërdorë emrin e dikujt tjetër, por normalisht me folë vetëm në emrin e vetë, sepse pikërisht për këtë po kalojnë katër muaj pa i formuar Komitetet.

**z.Reshat Mujota;** Është e vërtetë se unë në mbledhjen e kaluar e kam propozuar Heroinën. Këtu unë nuk kam ardhur për askend, jam këtu me qëndrimet e mija, dhe ju jeni ata që jeni kthyer te propozimet e mija. Le të ma gjen zyrtari ligjor se në cilën pikë unë nuk kam pas të drejtë. Unë nuk di më bërë marrveshje nëpër zyre. Besnik Seferi është ai që e ka propozuar Rexhep Gashin në KPF. Unë do ta lexoj diskutimin tim, (Në vazhdim lexoi tekstin e shkruar).

**z.Rexhep Gashi;** Përshëndetje, shpesh herë neve po na ndodhin këto gjëra, kjo krejt për arye të interesave personale. Atë ditë kemi ardhur në përfundim se ata që kanë përvojë mundën me e dhënë një kontribut më të mirë në këtë Komitet. Mbledhja ka qenë Live, nuk është mirë këtu me u lexuar procesverbalin, sepse procesverbalin do ta marrim në fund do të diskutojmë dhe do ta aprovojmë. Unë nuk kam bërë dhe nuk bëj asnjë marrveshje me askend.

**Kryetari, z.Qemaj Aliu;** Njësi matëse për atdhedashuri nuk janë asnjëra nga këto që i përmende, zoteri Mujota, e dinë ti fare mirë se far ligje janë miratuar e far vendime janë marrë në legjislationet e kaluara. Patriotizmi tregohet në këtë kohë vetëm me punë e angazhim maksimal për të mirën e atdheut dhe qytetarit. Prandaj unë mendoj se qytetarët e dinë këtë fare mirë.

**z.Përparim Ramusa;** Je tu mendu politikisht, ç' do votë është e rëndësishme.

**z.Besnik Seferi;** Po vazhdojmë përpara, unë nuk dua që të kthehem prapa.

**z.Përparim Ramusa;** Reshati duhet me u hjekë nga KPK-ja.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Dha 10 minuta pauzë në ora 10.00h. që të harmonizohen qëndrimet për propozimet e emrave që do ti jepni për tri komitetet përveq Komitetit për Komunitete.

Pas pauzës:

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Vazhdoi mbledhjen e Kuvendit në ora 10.07h.

Në vazhdim unë do ti lexoi emrat për të cilët u dakorduam me grupet parlamentare për të tri Komitetet si vijon:

1. Për Komitetin për Politikë dhe Financa u propozuan këta: Adnan Ademi, Përparim Ramusa, Lumin Amrushi, Adelina Beqaj, Sanije Sadiki, Kadri Emini, Heroina Selmani.

2. Për Komitetin për Arsimit Kulturë Rini dhe Sport-u propozuan këta: Hamëz Tërshani, Albana Podvorica, Rexhep Gashi, Asllan Beqaj, dhe Muhamet Ademaj.

3. Për Komitetin për Shëndetësi, Mirëqenie Sociale, Ambient dhe Shërbime Publike u propozuan këta: Hasan Avdyli, Adem Ramadani, Besartë Musliu-Spahija, Reshat Mujota, Besnik Seferi, Gëzim Haxhiu, dhe Rexhep Gashi.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Konstatoi, Kuorumin prej 21 anëtarëve prezent në mbledhje.

**\*Kuvendi i Komunës, me 19 vota "Për" me 0 vota "Kundër" dhe me 1 votë "Abstenim" miratoi në paket vendimin për zgjedhjen e anëtarëve të tri Komiteteve (KPF, KAKRS dhe KSHMSASHP) sipas rekomandimit të MAPL-së.**

Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit Npi-01/12 për zgjedhjen e KPK-së, sipas kërkesës të MPL-së  
Nr.020-108-3 të dt.16.02.2022.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Hapi diskutimin për këtë pikë.

**z.Kadri Emini;** Mendoj se për fillim është mirë me e sqaruar Kryesuesi se për tar arsye është kthyer ky vendim për formimin e KPK-së nga MAPL-ja, dmth, të sqarohet vetem arsyeja pse është kthyer.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Vendimi për zgjedhjen e KPK-së është kthyer për rishqyrtim nga MAPL-ja vetem për shkak të plotësimit të kuotës gjinore.

**z.Rrahman Jakupi;** Përshëndetje, krahas shkeljeve të identifikuara nga MAPL-ja, ne kemi gjetur edhe shkeljet e të cilat ne i kemi propozuar, këtu kemi sjellë “udhëzuesin e MAPL-së”, në vazhdim lexoi pjesë nga “Udhëzuesi”. Me qëllim që të ketë transparencë më shumë ju duhet që ti përmbaheni këtijë “Udhëzuesi”. Unë po kërkoj që të shtyhet kjo pikë për mbledhjen e radhës dhe të vazhdohet pastaj me procedurat për këtë Komitet. Kur të plotësohen këto ne do të japim propozimin tonë për këtë Komitet.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Ne jemi në vazhdimsi në kontakt për konsultime me MAPL-në, dhe unë e tregova arsyen se pse është kthyer për rishqyrtim ky vendim, i cili ka të bëjë vetëm me plotësimin e kuotës gjinore. Prandaj ju lus që ta jepni propozimin e juaj si PDK-ë dhe ta përfundojmë edhe zgjedhjen e Komitetit për Komunitete.

**z.Kadri Emini;** Ne jemi vonuar shumë në themelimin e komiteve, për këtë arsye duhet ta votojmë formimin e KPK-së. PDK-ja e ka të drejtën me e dhënë propozimin e sajë për anëtarë të këtijë komiteti, dhe më pastaj e ka edhe të drejtën e ankesës në Ministri, dhe nëse bëjmë shkelje ligjore ne prap mund ta përmirësojmë, por unë nuk jam për me e shty formimin e këtijë Komiteti. Kështu që unë e ftoj PDK-në që ta jep propozimin për një anëtare femër të KPK-së, nga subjekti i sajë dhe të shkojmë tutje.

**z.Përparim Ramusa;** Për mos me na e kthyer MAPL-ja ne emrin e kemi, por fillimisht i vazhdojmë procedurat e pas diskutimit publik ne do ta japim emrin.

**z.Rexhep Gashi;** Po diskutojmë për KPK-në. Te subjektet i kanë pru dy emra, ne nuk kemi qka me u konsultuar sepse subjektet i kanë pru dy emra, tani duhet ti japim emrat konkret.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Konstatoi, Kuorumin prej 21 anëtarëve prezent në mbledhje.

**\*Kuvendi i Komunës, me 9 vota “Për” me 10 vota “Kundër” dhe me 2 votë “Abstenim” nuk e miratoi propozimin e Rrahman Jakupi për shtyrjen e kësaj pike.**

**z.Përparim Ramusa;** Ne propozim nuk japim, sepse kemi mu ankuar .

**z.Kadri Emini;** Po lidhem me me diskutimin e Përparimit, sepse mungesa e emrit që e jep PDK-ja në këtë komitet nuk e penalizon paraqitjen e ankesës. Prandaj unë po them edhe njëherë që ta jepni propozimin e juaj për emrin e një antare femër dhe vazhdojmë më tutje.

**z.Përparim Ramusa;** Ne nuk japim emër sepse mendojmë që është shkelje ligjore, dhe nuk duam të marrim pjesë në një shkelje të tillë ku sigurisht se do ta kthen MAPL-ja.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Siq e thashë më parë nga Ministria ne nuk kemi vërejtje për këtë qështje por vërejtja është për shkakë të plotësimit të kuotës gjinore. Ju lusë edhe një herë që ta jepni propozimin e juaj.

**z.Përparim Ramusa;** Ne jemi të bindur qind per qind se po anashkalohen procedurat prandaj këtu nuk ka pse të ketë mirkuptim për këtë pikë.

**z.Rrahman Jakupi;** Në mbledhjet e kaluara ne e kemi permendur që ka pasë shkelje, por megjithate e kemi votuar. Në në këtë pikë do të abstenojmë, kështu që nese ju i keni numrat atëherë votojeni.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Unë e hodha në votim propozimin e juaj dhe nuk kalojë, tani në duhet ta gjejmë një zgjidhje.

**Kryetari, z.Qemajl Aliu;** Mirë u fillua mbledhja, ne kemi fol me MAPL-në dhe ata na kanë thënë, dhe e kemi edhe në formë të shkruar se te ky vendim është në pyetje vetëm plotësimi i kuotës gjinore. Atëherë mirë do të ishte që ti jepni emrat si subjekt për mos me dalë si bllokues të punës së Kuvendit. Më pastaj është MAPL-ja ajo që do të vendosë për ligjshmërin e vendimit. Nuk është mirë për

Kuvendin që ky komitet të mos zgjidhet, po ua kërkojë miqësishtë, sepse ligjëshmërinë nuk e përcaktojmë ne.

**z.Rrahman Jakupi;** Me këtë herë unë po e përmbylli diskutimin tim. Ne nuk marrim pjesë në këtë Komitet, deri sa të jemi të bindur, se janë respektuar procedurat. Ju mund ta vazhdoni por ne nuk do të marrim pjesë.

**z.Kadri Emini;** Edhe nëse mbahet diskutim publik për Komitetin, Kryetari e ka obligim me bërë propozimin në Kuvend për zgjedhjen e Komitetit, nga komuniteti pakicë. Nëse te Kryetari kanë ardhur më shumë emra se sa duhet të zgjidhen në Komitet, Kryetari e ka të drejtën me e bërë përzgjedhjen. Kuvendi dhunshëm askend nuk mundet me e obliguar për me marrë pjesë.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Dha 5 minuta pauzë në ora 10.36h. për konsultime.

Pas pauzës:

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Vazhdoi mbledhjen e Kuvendit në ora 10.57h.

**z.Rrahman Jakupi;** Ne jemi për ate që në këtë mbledhje të votohen vetëm anëtarët e Kuvendit, ndërsa në mbledhjen e ardhëshme të radhës të sillen emrat nga radhët e komuniteteve pakicë, dhe i votojmë për mos me bërë shkelje ligjore.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Ne nuk kemi asnjë problem me propozimet që kanë ardhur nga komunitetet, por me subjektet politike këtu në Kuvend, që problemi i këtijë vendimi është plotësimi i kuotës gjinore.

**z.Kadri Emini;** PDK-ja u deklarua që nuk ka propozim, atëherë në bazë të konsultimeve me Ministrinë që i patëm, mundësia për të dhënë propozim kalon te subjekti i dytë, kështu që ne e propozojmë Rrezartë Ramadanin.

**znj.Saniye Sadiki;** Ne nga subjekti politik LVV-ja e propozojmë Shkurte Mustafa dhe Besnik Seferi.

**z.Përparim Ramusa;** Besnik Seferi nuk bën me qenë edhe në Komitetin jo obligativ, në të dyjat sepse bën shkelje ligjore.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Udhëzimi Administrativ e thotë se nëse subjektit që i takon aspak nuk bën propozim, atëherë propozimin e bënë subjekti i dytë në Kuvend. Nuk i ndalohej Besnikut që të jetë në dy Komitete sepse nuk janë obligative, dhe kështu ka qenë edhe më parë.

**znj.Adelina Beqaj;** Deri kur më, me u kthyer te këto vendime?

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Ne biseduam dhe u konsultuam me MAPL-ë.

**z.Rrahman Jakupi;** Ne si PDK-ë nuk do të marrim pjesë në votim, për shkak të shkeljes së procedurave.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Konstatoi, Kuorumin prej 21 anëtarëve prezent në mbledhje.

**\*Kuvendi i Komunës, me 11 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 10 vota “Abstenim” miratoi Vendimin për zgjedhjen e Komitetit për Komunitete, sipas rekomandimit të MAPL-së .**

#### Pika 7

##### Propozim-Plani i Punës së Kuvendit për vitin 2022

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Hapi diskutimin për këtë pikë.

**z.Muhamet Ademaj;** Ne e kemi pasë një komision që ka punuar në hartimin e planit të punës dhe mendojë që ka bërë një punë të mirë, prandaj ne do ta votojmë.

**znj.Adelina Beqaj;** Unë kam një pyetje për komisionin se pse është raporti i DKA[-së në muajin Prill e jo në muajin Maj kur përfundon viti shkollor.

**z.Lulzim Sahiti, Drejtor i DKA;** Unë mendojë që informata të jetë në muajin qershor dhe tjetra në muajin Gusht.

**znj.Adelina Beqaj;** Unë pajtohem që informata të jetë në muajin Qershor.

**znj.Rrezartë Ramadani;** Përshendetje, ne si komision informaten e DKA-së e kemi vendosur ne muajin Korrik sepse ka qenë në muajin Qershor, e që mendojë se ka qenë një gabim teknik.

**z.Besnik Seferi;** Ne para vetit e kemi draft planin e punës të cilin edhe mundë ta ndryshojmë. Këtë qështjen e informatës së DKA[-së unë mendojë se është mirë ta aprovojme me propozimet e dhëna.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Konstatoi, Kuorumin prej 21 anëtarëve prezent në mbledhje.

\*Kuvendi i Komunës, me 20 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim” miratoi Planin e Punës të Kuvendit për vitin 2022 me propozimin që informata e DKA-së të kalojë në muajin Korrik.

#### Pika 8

#### Zgjedhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Hapi diskutimin për këtë pikë.

**z.Rrahman Jakupi;** Propozojë që përfaqësuesi i FSK-së të ndërrohet me Gëzim Morinen. Po ashtu propozojë që të shtohen edhe antarët Muhadin Halili, Përfaqësues i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi, si dhe Albert Ramadani, Përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike.

**z.Muhamet Ademaj;** Unë jam që KKSB-ja të votohet.

**z.Besnik Seferi;** Unë mendojë se nuk ka asgjë të keqe nëse lista e KKSB-së pasurohet me emra tjerë, por vetëm po kërkojë një sqarim për listën e propozuar nga Kryetari?

**z.Përparim Ramusa;** Është propozim i Kryetarit, po na bën nderë që të jemi unanim në aprovimin e këtij vendimi.

**Kryetari, z.Qemajl Aliu;** Me keqëardhje duhet ta themi për shkakë se nuk është formuar deri tani ky këshill, por i erdhi radha edhe kësaj është në kompetencën time që Kuvendit të ja propozojë emrat. Sa i përket përfshirjes së OJQ-ve në KKSB-ë ne e kemi propozuar Zhaneta Demiri përfaqësuese e OJQ-së “Vizionida”, prandaj nuk jam i mendimit që të ketë edhe një përfaqësues të dytë nga OJQ-të. Sa i përket FSK-së ajo mundë të dërgon vetë përfaqësuesin e saj cilin të dojë. Jam për me e shtu listën me Muhadin Halili dhe me Albert Ramadani. Sa i përket përfaqësuesit nga Komiteti për Komunitete aj shkon automatikisht Kryesuesi i KPK-së por kur te zgjidhet.


**z.Rrahman Jakupi;** Në bazë të U.A. ne e propozuam Albert Ramadani si përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike, dhe Muhadin Halilin si përfaqësues i Ekipit Veprues për Siguri.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Konstatoi, Kuorumin prej 21 anëtarëve prezent në mbledhje.

\* Kuvendi i Komunës së Shtime në vazhdimin e dytë të mbledhjes së dytë të rregullt për vitin 2022, të mbajtur më datën: 28.03.2022, unanimisht miratoi Vendimin për zgjedhjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi në Komunën e Shtimes.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Meqenëse diskutime tjera nuk kishte Kryesuesi, mbledhjen e përfundoi në ora 11.30h.

Procesmbajtësi:  
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Kuvendit  
Adnan Ademi

